

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e 39-të e Këshillit të Agjencisë për**  
**Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,**  
**të mbajtur më datë 06.10.2022**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes konferenciare:**  
Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /**

**Në mbledhje, përmes lidhjes konferenciare ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm përmes lidhjes konferenciare, nga Shërbimi profesional ishin:**  
m-r Dragica Ljubevska, m-r Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, m-r Ruzhica Boshnakoska Jotevska, d-r Ivana Stojanovska.

**Të pranishëm të tjerë: /**

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 39-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:10 dhe u realizua përmes lidhjes video konferenciare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi si vijon:

**R E N D I T E**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 29.09.2022
2. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit VINSAT KABEL nga Vinica për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
3. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit KABEL nga Strumica për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
4. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit KANAL 16 nga Resnja për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
5. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit NEOTEL SHPK nga Shkupi për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
6. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit SIGNAL-NET nga Kumanova për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
7. Propozim për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit SPAJDER-NET nga Gjevgjelia për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
8. Propozim për shqiptimin e procedurës për kundërvajtje ndaj operatorit ALTRA-SAT 2000 nga Ohri për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA.
9. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e seancës së 38-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 29.09.2022, me tekstin e propozuar.

## **Pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7**

Z. Trajçevski në lidhje me pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Rendit të ditës, propozoi që të arsyetohen me një hyrje të përbashkët sepse kanë të bëjnë me të njëjtën shkelje të nenit 141 nga LSHMAA. Informoi se një njërin prej Raporteve të mbikëqyrjes, më saktë në Raportin e pikës 5 gjatë përpilimit të materialit është bërë gabim teknik duke shtuar një shërbim programor më tepër se sa janë theksuar. Ky gabim është konstatuar pas dorëzimit të materialit deri te anëtarët e Këshillit, me ç'rast menjëherë është korrigjuar dhe në ueb faqen e Agjencisë është publikuar Raporti i korrigjuar i mbikëqyrjes së Shoqërisë për shërbime të telekomunikacionit NEOTEL SHPK import-eksport Shkup.

Z. Petrushevski tha se ka dashur që ta japë të njëjtin propozim, respektivisht pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Rendit të ditës të arsyetohen me një hyrje dhe diskutim të përbashkët, e më pas të votohet për secilën pikë në veçanti.

Anëtarët e Këshillit nuk kishin asgjë kundër këtij propozimi.

Z. Petrushevski tha se gjatë një bisede joformale ndërmjet anëtarëve të Këshillit kanë bërë një vërejtje parimore se dikush nga Shërbimi profesional kur të paraqitet për të arsyetuar ndonjë pikë është mirë që të kyçet edhe me kamerë, respektivisht të jetë në lidhje me video dhe me zë.

Udhëheqësja e Sektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale m-r Magdalena Davidovska Dovleva i arsyetoi propozimet për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit VINSAT KABEL SHPK nga Vinica, Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit KABEL SHPK nga Strumica, Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit- operatorit të rrjetit kabllor KANAL 16 SHPK nga Resnja, Shoqërisë të telekomunikimit dhe shërbimeve NEOTEL SHPK nga Shkupi, Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SIGNAL-NET SHPK nga Kumanova, Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SPAJDER-NET SHPKNJ nga Gjevgjelia.

Sqaroi se më 30 shtator të këtij viti skadoi regjistrimi i shërbimeve programore që ritransmetohen nga operatorët në bazë të kontratave që i lidhin me pronarët e të drejtave përmes LSAP. Gjatë ditës së parë të punës, që ishte 3 tetori, sektori realizoi gjithsejtë 20 mbikëqyrje ndaj 20 operatorëve me ç'rast u konstatua se në 7 prej tyre që tani janë si Rend dite, edhe krahas skadimit të regjistrimit, kanë vazhduar me ritransmetimin e këtyre shërbimeve programore që janë theksuar në raportet e shkruara të operatorit konkret.

Në ndërkohë janë rregulluar të drejtat dhe janë regjistruar shërbimet programore në Agjenci, por shkelja mbetet dhe për këtë arsye propozohet që të shqiptohet masa e vërejtjes publike.

Z. Fidanoski tha se nëse ka kuptuar mirë arsyetimin, në ndërkohë operatorët i kanë rregulluar të drejtat e ritransmetimit të shërbimeve të theksuara programore. Pyeti nëse ajo nënkupton se pas mbikëqyrjes kontrolluese, shikuesit nuk do të privohen nga programet e pakove që i paguajnë?

Udhëheqësja Davidovska Dovleva informoi se deri në këtë moment janë lidhur kontrata me 16 ose 17 operatorë dhe jo të gjithë kanë dorëzuar fletëparaqitje për regjistrimin e shërbimeve programore.

Por, shërbimet programore që janë të rregulluara në aspektin e të drejtave, mundën që të emetohen menjëherë. Ajo që ka rëndësi është se kontrata e përgjithshme e licencës është e nënshkruar dhe se secili operatorë që dëshiron, mund të parashtrojë fletëparaqitje deri te Agjencia, të marrë vërtetimin dhe të vazhdojë menjëherë me ritransmetim. Pjesa më e madhe e operatorëve edhe e kanë bërë këtë.

Z. Fidoski tha se tani e ka më të qartë dhe se pyetja e tij konkrete ka qenë për këto operatorë që janë në rend dite.

### Votimi për Pikën 2

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 11-3670/1 nga data 04.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë tregtare të televizionit kabllor VINSAT KABEL SHPK nga Vinica t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria tregtare e televizionit kabllor VINSAT KABEL SHPK nga Vinica, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në Rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e vet ka ritransmetuar shërbimet programore „HRT 1“, „HRT 3“, „HRT 4“, „Slovenia 1“, „Slovenia 2“ dhe „Slovenia 3“ që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 3

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 11-3672/1 nga data 04.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit KABEL SHPK nga Strumica t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria tregtare të radiodifuzionit KABEL SHPK nga Strumica, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në Rajonin e Komunës së Vallandovës, për shfrytëzuesit e vet ka ritransmetuar shërbimet programore „ Rai Uno“, „Sat 1“ dhe „RTL II “që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 11-3674/1 nga data 04.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit- operatorit të rrjetit kabllor KANAL 16 SHPK nga Resnja t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria tregtare të radiodifuzionit- operatorit të rrjetit kabllor KANAL 16 SHPK nga Resnja, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në Rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e vet më datë 3 tetor ka ritransmetuar shërbimet programore „ HRT 3“, „RTCG Sat “që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 5

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të rregullt programore, nr. 11-3675/3 nga data 05.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë të telekomunikimit dhe shërbimeve NEOTEL SHPK import-eksport nga Shkupi t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria e telekomunikimit dhe shërbimeve NEOTEL SHPK import-eksport nga Shkupi, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në Rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e vet ka ritransmetuar shërbimet programore „HRT 1“, „HRT 3“, „HRT 4“, „RTL“, „SAT 1“, „TVE“, „Rai Uno“, „Rai Due“, „Arte“ „Film Box Extra“ dhe „TRT Turk“ që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 6

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të jashtëzakonshme programore, nr. 11-3671/1 nga data 04.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SIGNAL-NET SHPK nga Kumanova t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime SIGNAL-NET SHPK nga Kumanova, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në Rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e vet ka ritransmetuar shërbimet programore „RTL“, „RTL II“, „HRT 3“, „VOX“ „Super RTL“ и „TRT Turk“ që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 7

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar rregullt programore, nr. 11-3673/1 nga data 04.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SPAJDER-NET SHPKNJP nga Gjevgjelia t'i shqiptoj masën e vërejtjes publike për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA dhe në pajtim me Pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, e obligoi që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e vet me LSHMAA.

Me mbikëqyrjen ishte konstatuar se Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime SPAJDER-NET SHPKNJP nga Gjevgjelia, që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në rajonin e Komunës së Gjevgjelisë dhe Bogdancit, për shfrytëzuesit e vet më 2 tetor ka ritransmetuar shërbimet programore „Slovenia 2“, „ERT World“, „RAI Uno“, „HRT 1“, „HRT 3“, „RTCG Sat“ dhe „TRT Turk“ që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Aktvendimin për shqiptimin e masës së vërejtjes publike ndaj operatorit të theksuar.

Sektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale pas skadimit të afatit të përcaktuar sipas Aktvendimit për vërejtje publike, të realizojë mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 8**

Udhëheqësja e Sektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejta Autoriale m-r Magdalena Davidovska Dovleva e arsyetoi Propozimin për shqiptimin e procedurës për kundërvajtje ndaj operatorit ALTRA-SAT 2000 nga Ohri për shkeljen e nenit 141 nga LSHMAA. Sqaroi se bëhet fjalë për grupin e njëjtë të shërbimeve programore. Ai ka ritransmetuar gjithsejtë 13 shërbime të paregjistruara programore. Me mbikëqyrjen e rregullt që është bërë në mars të vitit 2022 gjithashtu është konstatuar se janë ritransmetuar shërbime të paregjistruara programore. Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme është konstatuar se ky operator ka vazhduar me të njëjtën shkelje të nenit 141 nga LSHMAA gjatë vitit të njëjtë. Në pajtim me Ligjin propozohet që të iniciohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Z. Petrushevski tha se ky është rast i qartë sepse ka përsëritje të shkeljes. Pyeti nëse në periudhën prej marsi deri në tetor të vitit 2022 ekzistojnë dyshime se operatori e ka bërë këtë shkelje ose tanimë është vështirë që të dëshmohet?

Z. Trajçevski sqaroi se tani nuk e ka Raportin para veti, por këto shërbime programore për të cilat tani i shqiptohet kallëzimi për kundërvajtje janë sigurisht më ndryshe se ato në mars, sepse atëherë kontrata për të drejtat autoriale nuk ka qenë e skaduar, ajo ka skaduar më 30 shtator. Por, me që bëhet fjalë për të njëjtën shkelje, ritransmeton shërbime programore pa të drejta të rregulluara autoriale, për të cilat i shqiptohet kallëzim për kundërvajtje, ai e përsërit të njëjtën shkelje. Në ndërkohë janë bërë mbikëqyrje dhe nëse e ka shkelur Ligjin sigurisht se do të kishte propozime për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

Z. Petrushevski tha se e gëzon fakti që nuk janë dyshimet e tija nuk janë të sakta. Propozohet iniciimi i procedurës për kundërvajtje sepse e ka përsëritur të njëjtën vepër në të njëjtin vit.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar të jashtëzakonshme programore, nr. 11-3676/1 nga data 04.10.2022 ndaj Shoqërisë tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA-SAT 2000 SHPKNJP nga Ohri dhe konstatoi shkelje të nenit 141 nga LSHMAA.

Këshilli i Agjencisë njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA-SAT 2000 SHPKNJP nga Ohri të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrjen është konstatuar se operatori i theksuar që sipas notifikimit të Agjencisë për Komunikime Elektrike mund të realizojë veprimtarinë në rajonin e Komunës së Ohrit, për shfrytëzuesit e vet më ka ritransmetuar shërbimet programore, „RTL“, „RTL II“, „Super RTL“, „VOX“, „Rai Uno“, „Rai Due“, „HRT 1“, „HRT 3“, „HRT 4“, „Slovenia 1“, „RTCG Sat“, „Sat 1“ dhe „PRO Sieben“ që nuk janë të përfshirë me vërtetimin për regjistrimin e shërbimeve programore, të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike duhet ta përgatis Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente ndaj operatorit të theksuar.

## **Pika 9**

### **Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk kishte diskutim.

**Nr. 02-3699/9  
21.10. 2022**

**Shkup**

**Agjencia për shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit,  
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**